



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr. 6/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën [REDACTED] me vendbanim rruga [REDACTED] Frankfurt am Main, në Gjermani, parashtruar ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të anulimit të aplikimit për të votuar si votues jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me date 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 20.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ANKESA ZP Anr 6/2026 e datës 18.05.2026, e parashtruar nga [REDACTED] me vendbanim rruga [REDACTED] Frankfurt am Main, në Gjermani, për shkak të anulimit të aplikimit për të votuar si votues jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me date 07 Qershor 2026,

Arsyetim

Më datë 18.05.2026, PZAP-i, përmes e-mailit zyrtar ka pranuar një ankesë ZP.Anr.6/2026 nga [REDACTED] ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për shkak të anulimit të regjistrimit si votues jashtë Kosovës, si dhe ndaj mungesës së një trajtimi të rregullt, transparent dhe të arsyetuar me shkrim pas ankesës zyrtare dhe të detajuar.

Në ankesë ka theksuar se, kërkesa e tij për votim jashtë Kosovës në Përfaqësinë Diplomatike/Konsullatën e Republikës së Kosovës në Frankfurt ishte miratuar zyrtarisht nga KQZ, dhe se ka pranuar njoftimin zyrtar se emri i tij është vendosur në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe se mund të votoj më 06.06.2026.

Sipas parashtruesit të ankesës me datë 16.05.2026 rreth orës 14:14, i njëjti ka pranuar një telefonatë përmes Viber-it nga një numër i panjohur, nga i cili iu është bërë verifikimi zyrtar, duke pretenduar se, problemi kryesor nuk ishte vetë verifikimi, por mënyra jashtëzakonisht joprofesionale dhe e paqartë se si u zhvillua telefonata. Komunikimi është bërë në mënyrë tepër jozyrtare, përfshirë faktin që personi i është drejtuar në formë familjare me "ti", dhe se kjo procedurë zyrtare për verifikimin e të dhënave personale dhe të së drejtës së votës është joprofesionale dhe e papërshtatshme. Në këtë rast sipas ankuesit nuk bëhet fjalë për mungesë arritshmerisë, sepse i njëjti i është përgjigjur telefonatës së KQZ-së, por nga mungesa e

identifikimit zyrtar, mungesa e transparencës dhe mënyra joprofesionale e zhvillimit të telefonatës.

Me tutje ka theksuar se, vetëm pak minuta pas kësaj telefonate, ka pranuar njoftimin me e-mail se statusi i cili më parë ishte i miratuar, tani ishte anuluar me arsyetimin se të dhënat nuk janë verifikuar përmes telefonit dhe se i njëjti nuk ishte më në një proces të hapur regjistrimi, por tashmë kishte marr miratimin zyrtar. Parashtruesi shton se nuk është e pranueshme që mungesa e trajnimit, mungesa e profesionalizmit ose mënyra e dobët e komunikimit nga ana e një zyrtareje të kthehet në humbje faktike të së drejtës së votës për një qytetar. Një telefonatë e dytë e rregullt, një e-mail zyrtar ose një sqarim profesional, ku do të bëhej e qartë kush telefonon dhe për çfarë arsye, do të kishte mjaftuar për ta shmangur të gjithë këtë situatë.

Pas kësaj, ka paraqitur ankesë me shkrim pran KQZ-së, dhe ka kërkuar rishqyrtimin e anulimit, rikthimin e statusit si votues i miratuar, identifikimin e personit përgjegjës, bazën ligjore konkrete dhe dokumentacionin mbi të cilin është bazuar anulimi dhe se deri më tani nuk ka pranuar përgjigje nga KQZ.

Ankuesi, kërkon nga PZAP-i që të shqyrtojë ligjshmërinë dhe rregullsinë e anulimit të regjistrimit për votim jashtë Kosovës, i cili ishte tashmë i miratuar zyrtarisht. Si provë në ankesë ka bashkangjitur kopje të njoftimeve nga KQZ, përmes e-mail adresës.

Në përgjigje në kërkesë KQZ-ja, ka theksuar se shtetas [REDACTED] (më tej ankuesi), me numër personal të identifikimit të Republikës së Kosovës [REDACTED] ka aplikuar përmes platformës elektronike. Divizioni i shërbimit të votuesve, ka shqyrtuar dhe aprovuar aplikimin e ankuesit dhe i njëjti është njoftuar përmes e-mailit, në e-mail adresën e dhënë gjatë aplikimit [REDACTED] Divizioni i shërbimit të votuesve, në përputhje me Procedurën Standarde e Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës, ka bërë verifikimin e votuesve të regjistruar, ku me datë 16.05.2026, është kontaktuar për verifikim edhe ankuesi për faktin se në adresën e deklaruar të vendbanimit jashtë Kosovës ishin regjistruar edhe 5 shtetas tjerë me mbiemër tjetër, që përkon me rrethanat e përcaktuara në Procedurën Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosove, përkatësisht në pikën 2.7.2 ku thuhet se: *“Nëse mbiemrat e aplikuesëve janë të ndryshëm dhe kanë bashkangjitur adresën e njëjtë të banimit apo numri i telefonit dhe e-mail adresa është e dyshimtë, shërbimi votues do t’i kontaktoj përmes telefonit apo video thirrjeve për të bërë verifikimin”*. Gjatë zbatimit të procedurës së verifikimit, përkatësisht komunikimit me telefon është zbatuar neni 2.7.3 i Procedurës ku thuhet *“Gjatë komunikimit me telefon nga aplikuesi do të kërkohen të dhënat: emri dhe mbiemri, data e lindjes, adresa e banimit jashtë Kosovës. Nëse këto të dhëna përputhen me të dhënat që janë paraqitur gjatë aplikimit, kërkesa e aprovuar konsiderohet si e rregullt, në të kundërtën kërkesa e aprovuar do të anulohet.”* Më tej në përgjigje theksohet se ankuesi, gjatë procedurës së verifikimit (thirrjes) nuk ka pranuar të verifikoj të dhënat, për rrjedhojë aplikimi i të njëjtit është anuluar me datë 16/05/2026 14:26 për çka është njoftuar përmes e-mailit.

Ankuesi, përmes postës elektronike ka paraqitur ankesë për anulim me datë 16.05.2026, ku ndër të tjera kishte kërkuar që të kalohet rastit te një mbikëqyrës ose person përgjegjës i KQZ-së, i cili nuk ka qenë i përfshirë drejtpërdrejt në telefonatat dhe në anulimin e kërkesës.

KQZ, sqaron se në përgjigje të kërkesës së ankuesit, me datë 16.05.2026, pas e-mailit të pranuar, i njëjti është kontaktuar nga Udhëheqësi i Divizionit të Shërbimit për Votues, ku të njëjti i është sqaruar baza ligjore për verifikim, procedura e verifikimit dhe i njëjti është inkurajuar të ri aplikoj. Përsëri, me datë 17.05.2026, në ora 12:02, ankuesi është informuar përsëri përmes e-mailit për bazën ligjore të verifikimit, arsyen e anulimit dhe është inkurajuar të ri aplikoj deri në përfundim të periudhës së regjistrimit në të njëjtën ditë në ora 23:59. Ankuesi, nuk ka shfrytëzuar të drejtën e ri aplikimit deri në përfundim të periudhës së regjistrimit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore konstatoi se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli, pasi shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, pasi që parashtruesi i ankesës gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas paragrafit 4 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës të KQZ-së, në të cilin është përcaktuar se *“4. Kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ bëhet si në vijim: 4.1. Plotëson të dhënat e adresës së banimit jashtë Kosovës: shtetin, kodin postar, qytetin, emrin e rrugës, numrin e banesës apo shtëpisë; 4.2. Plotëson email adresën personale dhe numrin e telefonit mobil personal; 4.3. fotografon njërin prej dokumenteve identifikuese të lëshuara nga Republika e Kosovës, si letërnjoftim, pasaportë ose patentë shofer, duke mos përjashtuar dokumentet me afat të skaduar; 4.4. fotografon dokumentin që dëshmon adresën e votuesit jashtë Kosovës, sikurse në nën paragrafin 4.1... ”.*

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndëve dhe përgjigjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Paneli arriti në përfundimin se parashtruesi i ankesës, gjatë aplikimit për regjistrim votim jashtë Kosovës përmes platformës elektronike të KQZ-së, nga verifikimi i këtyre dëshmimeve paneli vlerëson se, në e-mail adresën [redacted] ish-in regjistruar disa shtetas tjerë me mbiemër të ndryshëm. Me dispozitën e nenit 2.7.2. të Procedurës Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosove, parashihet që: *“Nëse mbiemrat e aplikuesëve janë të ndryshëm dhe kanë bashkangjitur adresën e njëjtë të banimit apo numri i telefonit dhe email adresa është e dyshimtë, shërbimi votues do t'i kontaktoj përmes telefonit apo video thirrjeve për të bërë verifikimin. Gjatë zbatimit të procedurës së verifikimit, përkatësisht komunikimit me telefon është zbatuar neni 2.7.3 i Procedurës ku thuhet “Gjatë komunikimit me telefon nga aplikuesi do të kërkohen të dhënat: emri dhe mbiemri, data e lindjes, adresa e banimit jashtë Kosovës. Nëse këto të dhëna përputhen me të dhënat që janë paraqitur gjatë aplikimit, kërkesa e aprovuar konsiderohet si e rregullt, në të kundërtën kërkesa e aprovuar do të anulohet.”* Bazuar në dispozitën e këtij neni KQZ-ja ka bërë verifikimin e aplikuesit për faktin se në adresën e deklaruar të vendbanimit jashtë Kosovës ish-in regjistruar edhe disa shtetas tjerë me mbiemër tjetër, nga i cili komunikim ka rezultuar se i njëjti ka refuzuar që ti jep të dhënat e tij ashtu siç parashihet me dispozitën nenit të lartcekur, ku për rrjedhojë aplikimi i të njëjtit është anuluar me datë 16.05.2026.

Në këto rrethana, Paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës me datë 16.05.2026, pas e-mailit të pranuar, është kontaktuar nga Udhëheqësi i Divizionit të Shërbimit për Votues, ku të njëjti i është sqaruar baza ligjore për verifikim, procedura e verifikimit dhe i njëjti është inkurajuar

të ri aplikoj. Po ashtu më datë 17.05.2026, në ora 12:02, ankuesi është informuar përsëri përmes e-mailit për bazën ligjore të verifikimit, arsyen e anulimit dhe është inkurajuar të ri aplikoj deri në përfundim të periudhës së regjistrimit në të njëjtën ditë në ora 23:59. Mirëpo, ankuesi, nuk ka shfrytëzuar të drejtën e ri aplikimit deri në përfundim të periudhës së regjistrimit.

Paneli pas analizimit dhe vlerësimit të provave materiale dhe pretendimeve ankimore, PZAP vlerëson se, në këtë çështje administrative, drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, andaj pretendimet e ankuesit nuk janë te bazuara.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Andaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, 118 paragrafi 1, neni 119 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe në bazë të nenit 9 paragrafi 5.3 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
ZP.Anr. 6/2026 më datën 20.05.2026

Kryesuese e Panelit  
Hidajete Gashi Alaj



KËSHILLAJURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.

Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborimi Panel za žalbe i Predstavke

26 -05- 2026

Prishtinë / Priština

Nr./Br. 610 Ora/Sat 11:37



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.22/2026

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Bajrami, kryetar, Franciska Zhitija Ymeri dhe Lumni Sallauka, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së Sabahudin Shatrolli, me vendbanim në Frankfurt am Main në Gjermani, rruga "Otostrabe 14" 60329, për shkak të anulimit të aplikimit për të votuar jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, që do të mbahen me datë 07 Qershor 2026, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.6/2026, të datës 20.05.2026, në seancën e mbajtur më datë 26.05.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Sabahudin Shatrolli nga Gjermania, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ZP.Anr.6/2026, të datës 20.05.2026.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ZP.Anr.6/2026, të datës 20.05.2026, është vendosur: "Refuzohet e pabazuar ankesa ZP Anr 6/2026, e datës 18.05.2026, e parashtruar nga Sabahudin Shatrolli, me vendbanim rruga "Otostrabe 14" 60329, Frankfurt am Main, në Gjermani, për shkak të anulimit të aplikimit për të votuar si votues jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 07 Qershor 2026".

Kundër vendimit të lartpërmendur, Sabahudin Shatrolli, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, duke propozuar që Gjykata Supreme të aprovojë ankesën e Sabahudin Shatrolli si të bazuar, ndërsa të shqyrtojë ligjshmërinë dhe rregullsinë e anulimit të regjistrimit për votim jashtë Kosovës.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të Sabahudin Shatrollit, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore të paraqitësit të ankesës duke vlerësuar se në këtë çështje administrative, gjendja faktike është vlerësuar drejt, nga çka rrjedh se nuk është cënuar ligji në dëm të ankuesit, ndaj propozoi që ankesa e ankuesit Sabahudin Shatrolli të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZP.Anr.6/2026, i datës 20.05.2026.



Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 18.05.2026, PZAP-i, përmes e-mailit zyrtar ka pranuar ankesën e Sabahudin Shatrolli, të parashtruar ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për shkak të anulimit të regjistrimit si votues jashtë Kosovës. Në ankesë është pretenduar gjithashtu mungesa e një trajtimi të rregullt, transparent dhe të arsyetuar me shkrim nga ana e KQZ-së. Ankuesi ka deklaruar se kërkesa e tij për votim jashtë Kosovës në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Frankfurt ishte aprovuar zyrtarisht nga KQZ-ja dhe se ai kishte pranuar njoftimin se emri i tij ishte futur në listën e votuesve jashtë Kosovës me të drejtë votimi më 06.06.2026. Sipas ankuesit, më 16.05.2026, rreth orës 14:14, ai kishte pranuar një telefonatë përmes Viber-it nga një numër i panjohur, gjatë së cilës ishte bërë verifikimi zyrtar, mirëpo i njëjti pretendon se problemi nuk lidhet me vetë verifikimin, por me mënyrën jo profesionale dhe jo të qartë të zhvillimit të telefonatës, gjë që sipas tij nuk është e përshtatshme për një procedurë zyrtare që lidhet me të dhënat personale dhe të drejtën e votës. I njëjti ka theksuar se nuk kishte refuzuar të përgjigjej por se kishte pasur mungesë identifikimi zyrtar dhe transparence nga personi që e kishte telefonuar. Ai më tutje ka shtuar se pak minuta pas telefonatës, i kishte ardhur një email, ku ishte njoftuar se statusi i tij, i cili më parë i ishte miratuar, tani ishte anuluar me arsyetimin se të dhënat nuk ishin verifikuar përmes telefonit. Sipas tij, nuk është e pranueshme që mungesa e profesionalizmit ose komunikimi i dobët nga një zyrtar të rezultojë në humbjen faktike të së drejtës së votës. Nga të lartcekurat, ankuesi kishte paraqitur ankesë në KQZ, duke kërkuar rishqyrtimin e vendimit për anulim, rikthimin e statusit të votuesit të aprovuar, identifikimin e personit përgjegjës si dhe bazën ligjore dhe dokumentacionin mbi të cilin ishte mbështetur anulimi, por që nuk kishte marrë përgjigje nga të njëjtët. Nga PZAP, ankuesi ka kërkuar që të vlerësojë ligjshmërinë dhe rregullsinë e anulimit të regjistrimit për votim jashtë Kosovës, duke theksuar se regjistrimi i tij fillimisht kishte qenë i miratuar zyrtarisht.

Në përgjigjen e saj në ankesë, KQZ ka sqaruar se ankuesi kishte aplikuar në mënyrë elektronike për regjistrim si votues jashtë Kosovës dhe se aplikimi fillimisht i ishte aprovuar nga Divizioni i Shërbimit të Votuesve. Më pas, gjatë procesit të verifikimit, Divizioni i Shërbimit të Votuesve, në përputhje me Procedurën Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve jashtë Kosovës, me datë 16.05.2026 kishte kontaktuar ankuesin për verifikim, pasi që kishte konstatuar se në adresën e deklaruar të vendbanimit jashtë Kosovës, ishin regjistruar edhe pesë persona të tjerë me mbiemra të ndryshëm, gjë që sipas procedurave standarde kërkonte verifikim shtesë përmes telefonit apo video thirrjes. KQZ ka theksuar se gjatë telefonatës së verifikimit, ankuesi nuk kishte konfirmuar të dhënat e kërkuara sipas procedurave standarde, për çka aplikimi i tij ishte anuluar më 16.05.2026, për të cilin vendim sipas KQZ-së, i njëjti ishte njoftuar edhe përmes emailit.

Gjithashtu, KQZ ka deklaruar se ankuesi kishte kërkuar që rasti të shqyrtohet nga një mbikëqyrës ose person tjetër përgjegjës, duke pretenduar se personi që e kishte zhvilluar telefonatën nuk duhej të ishte përfshirë në anulimin e aplikimit. Sipas KQZ-së, me datë



16.05.2026 ankuesi kishte marr përgjigje nga Udhëheqësi i Divizionit të Shërbimit për Votues, ku i ishte shpjeguar baza ligjore e procedurës së verifikimit dhe ishte inkurajuar që të riaplikonte. Po ashtu, më 17.05.2026, ai ishte njoftuar sërish përmes e-mailit mbi arsyet e anulimit dhe mundësinë për të aplikuar përsëri deri në përfundim të afatit të regjistrimit, por që ankuesi nuk e kishte shfrytëzuar këtë mundësi.

PZAP, në arsyetim të vendimit të atakuar ndër të tjera ka theksuar se, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, ka ardhë në përfundim se ankesa është e pabazuar. Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, ka vlerësuar se ankuesi nuk ka përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara si votues jashtë Kosovës, sipas paragrafit 4 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, të KQZ-së, ku përcaktohet detyrimi për plotësimin e të dhënave personale, dokumenteve identifikuese dhe dëshmime të adresës së banimit jashtë Kosovës. Paneli ka arritur në përfundim se verifikimi shtesë ishte bërë për shkak se në adresën e deklaruar të vendbanimit jashtë Kosovës të ankuesit, ishin regjistruar edhe disa shtetas tjerë me mbiemër tjetër dhe se sipas procedurave standarde në raste të tilla kërkohet verifikim përmes telefonit apo video thirrjes. Paneli ka vlerësuar se ankuesi nuk i kishte paraqitur të dhënat e kërkuara gjatë komunikimit në telefon, prandaj anulimi i aplikimit ishte bërë në përputhje me dispozitën e nenit 2.7.3 të Procedurës Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës. Pra, paneli ka vlerësuar se ankuesi ishte njoftuar me kohë për procedurat e verifikimit, bazën ligjore dhe mundësinë për të riaplikuar brenda afatit të regjistrimit, por që i njëjti nuk kishte vepruar në këtë drejtim, andaj paneli vlerësoi se pretendimet e ankuesit janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë, ankuesi nuk ka arritur që t'i provoj me asnjë prove të vetme.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me refuzimin e ankesës së Sabahudin Shatrolli, për shkak të anulimit të aplikimit për të votuar jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, që do të mbahen me datë 07 Qershor 2026. Vendimi i PZAP është i drejtë, i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregulloren Zgjedhore 04/2025. Kjo për faktin se në këtë rast nuk ka rezultuar se KQZ në mënyrë të kundërligjshme ka marr vendim për anulimin e regjistrimit të ankuesit si votues jashtë Kosovës.

Gjykata Supreme vlerëson se PZAP në mënyrë të drejtë dhe të bazuar në prova ka konstatuar se ankuesi nuk ka përmbushur kriteret e kërkuara për regjistrim si votues jashtë Kosovës dhe se anulimi i aplikimit është bërë në pajtim me ligjin dhe rregulloren zgjedhore në fuqi. Paragrafi 4, neni 3 i Rregullorës Zgjedhore nr. 4/2025 përcakton: "4.Kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ bëhet si në vijim: 4.1 Plotëson të dhënat e adresës së banimit jashtë Kosovës: shtetin, kodin postar, qytetin, emrin e rrugës, numrin e banesës apo shtëpisë; 4.2 Plotëson email adresën personale dhe numrin e telefonit mobil personal; 4.3 fotografon njërin prej dokumenteve identifikuese të lëshuara nga Republika e Kosovës, si letërnjoftime pasaportë ose patentë shofer, duke mos përjashtuar dokumentet me afat të skadencës, 4.4



*fotografon dokumentin që dëshmon adresën e votuesit jashtë Kosovës, sikurse në nën paragrafin 4.1...*”

Nga shkresat e lëndës rezulton se gjatë procesit të verifikimit të votuesve të regjistruar nga ana e Divizionit të shërbimit të votuesve, është vërtetuar fakti se në adresën e deklaruar të vendbanimit jashtë Kosovës të ankuesit, ishin regjistruar edhe pesë shtetas tjerë, me mbiemra të ndryshëm, për çka ankuesi është kontaktuar për verifikim, mirëpo i njëjti gjatë procedurës së verifikimit nuk ka pranuar t'i verifikojë të dhënat, ku si rrjedhojë, me datë 16.05.2026, aplikimi i të njëjtit është anuluar. Procedura Standarde e Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës, në pikën 2.7.2 përcakton: *“Nëse mbiemrat e aplikuesve janë të ndryshëm dhe kanë bashkëngjitur adresën e njëjtë të banimit apo numri i telefonit dhe e-mail adresa është e dyshimtë, shërbimi votues do t'i kontaktojë përmes telefonit apo video thirrjeve për ta bërë verifikimin”*. Gjatë zbatimit të procedurës së verifikimit, përkatësisht komunikimit me telefon, është zbatuar neni 2.7.3 i Procedurës, i cili përcakton: *“Gjatë komunikimit me telefon, nga aplikuesi do të kërkohen të dhënat: emri dhe mbiemri, data e lindjes, adresa e banimit jashtë Kosovës. Nëse këto të dhëna përputhen me të dhënat që janë paraqitur gjatë aplikimit, kërkesa e aprovuar konsiderohet si e rregullt, në të kundërtën kërkesa e aprovuar do të anulohet”*. Pasi që ankuesi gjatë procedurës së verifikimit nga ana e Divizionit të shërbimit të votuesve, ka refuzuar t'i ofrojë të dhënat e kërkuara për verifikim, KQZ në kuadër të kompetencave të saja ligjore dhe në përputhje me procedurat zgjedhore në fuqi, me të drejtë të njëjtit i ka anuluar aplikimin për regjistrim si votues jashtë Kosovës.

Për më tepër, nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi është njoftuar me kohë për arsyet e anulimit të aplikimit dhe mundësinë e riaplikimit brenda afatit të përcaktuar për regjistrim, mirëpo i njëjti nuk e ka shfrytëzuar këtë mundësi procedurale.

Pretendimet e ankuesit lidhur me mënyrën e komunikimit nga ana e zyrtarit të KQZ-së, mungesën e profesionalizmit apo mënyrën jo formale të zhvillimit të telefonatës, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk kanë ndikim në ligjshmërinë e procedurës së verifikimit dhe nuk e bëjnë të kundërligjshëm vendimin për anulimin e aplikimit. Gjykata konsideron se thelbësore në këtë rast është fakti nëse janë përmbushur kushtet dhe kriteret e nevojshme për verifikimin e identitetit dhe të dhënave të aplikuesit, e jo forma e komunikimit në mes të palëve.

Gjykata Supreme ankesën e ankuesit e ka vlerësuar të pabazuar, kjo për faktin se e njëjta nuk është e mbështetur në prova bindëse të cilat do të vërtetonin shkeljet e supozuara, respektivisht ankuesi Sabahudin Shatrolli, vetëm ka theksuar se e kundërshton vendimin ZP.Anr.6/2026, të datës 20.05.2026, mirëpo në këtë rast nuk mjafton vetëm kundërshtimi i vendimit të lartcekur, mirëpo duhet që me prova konkrete të vërtetohet saktë parregullsia apo shkelja e pretenduar, gjë të cilën ankuesi nuk e ka bërë ngase ankesës nuk i ka bashkëngjitur asnjë provë të vetme me të cilën do ta vërtetonte parregullsinë e pretenduar.

Gjykata Supreme vlerëson se ankuesi nuk ka ofruar dëshmi që do të mund të vërtetonin shkeljet e lartcekura, kjo duke marrë për bazë edhe nenin 117 paragrafi 3 të LZP-së, i cili ka përcaktuar se: *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, mirëpo ankuesi Sabahudin Shatrolli, nuk ka arritur të provojë në asnjë mënyrë faktin se KQZ, në mënyrë të kundërligjshme i ka anuluar aplikimin për të votuar si votues jashtë Kosovës për Zgjedhjet



e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 07 Qershor 2026. Andaj në mungesë të dëshmimit të parregullsisë së pretenduar edhe është vlerësuar e pabazuar ankesa e ankuesit.

Gjykatës Supreme e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të PZAP-it. Kjo pasi që gjykata vlerëson se PZAP në mënyrë të drejtë dhe të bazuar në prova ka konstatuar se ankuesi nuk ka përmbushur kriteret e kërkuara sipas Rregullores zgjedhore në fuqi për regjistrim si votues jashtë Kosovës dhe se anulimi i aplikimit është bërë në pajtim me ligjin dhe procedurën zgjedhore në fuqi, andaj edhe Gjykata Supreme e ka pranuar vendimin e saj si të ligjshëm dhe të drejtë dhe e ka refuzuar të pathemeltë ankesën e ankuesit në këtë drejtim.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
AA.nr.22/2026, datë 26.05.2026

Kryetari i kolegjit

Faton Bajrami



Republika e Kosovës  Republika Kosovo  
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Funttori i autorizuar  
Gjykatës Supreme  
